

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë euro. 'Paraqitën forcë n' edhe disa gjyqtare dhe prokurorë të SPAK-ut. Stafeta i kalon Ron Yeffet
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/23/grate-e-pd-se-qe-u-shtrine-ne-zyren-gys-agasit-njera-u-shfaq-me-makine-70-mije-euro-paraqiten-forcen-edhe-disa-gjyqtare-dhe-prokurore-te-spak-ut-stafeta-i-kalon-ron-yeffet/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:48:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 08:35:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f38be362c1243a0c9bde6e388b42d733cc09d9a5340a9cf590261585386126b4
TEKSTI	e8e598d135256f4948dbe7a35d13d1948a20298cdc4b5e2c3a79a1beb89a59ee
PAMJA	35a2e115ee37dcb918ccc92aa2eb351b5d7e946821bbf00668459a897d817032

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aaf57eeea9775839113db23a7ba5c91cafae6551d22167be3fda2c2cd308bee4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/aaf57eeea9775839113db23a7ba5c91cafae6551d22167be3fda2c2cd308bee4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

G

ratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë euro.

'Paraqitën forcën' edhe disa gjyqtare dhe prokurorë të SPAK-ut. Stafeta i kalon Ron Yeffet

Dosje rozë

Publikuar: 23/09/2026

f X



Me te lexuarat

- Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë euro me... /
- "Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te... /
- Benet Becit, si po i pastrojnë paratë e korrupsionit me tandra n... /
- dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te... /
- Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

Filimimet në zyrën e Ergys Agasit po konsiderohen si një 'minierë ari' në duart e SPAK jo vetëm për zbardhjen e disa abuzimeve të dyshuara me pasuritë publike, por edhe për skanimin e mënyrës së funksionimit të shtetit, duke nisur që nga Shërbimi Informativ Shtetëror, institucion kyç për sigurinë kombëtare. Zyra e tij ishte kthyer si një kryeministri paralele, më efikase dhe e aksesueshme se sa zyra e shefit të qeverisë, ku merrnin zgjidhje disa nga hallet dhe problemet në raport me shtetin.

Gjatë paraqitjes para gjykatës dy ditë më parë, Ergys Agasi ka pranuar se ka pasur takime me ministra dhe drejtues institucionesh, por ka mohuar kategorikisht se ato kanë qenë të lidhura me korrupsion. "Kam takuar ministra e drejtorë, por më provoni që kam bërë korrupsion", mësohet të jetë shprehur biznesmeni para gjykatës.

Drejtuesia e SHISH-it Vora Hyseni dhe ish drejtoresha e Ajiensisë

Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit Mirlinda Karçanaj janë vetëm disa nga zonjat që frekuentonin zyrën e famshme të Gys Agasit, të cilat SPAK i akuzon edhe për veprimtari të paligjshme. Zyrën e Gys Agasit mësohet se e kanë vizituar shpesh edhe disa zonja të Partisë Demokratike, anëtare të strukturave të larta drejtuese të PD-së, kandidatë për deputete dhe ish deputete të kësaj partie.

Një zonjë shumë pranë Berishës, të cilin madje e kundron me aq ëmbëlsi, në një rast është ndeshur me gazetarin e Familjes Berisha në derën e zyrës së Gys Agasit, ajo duke hyrë dhe ai duke dalë. Në derën e zyrës në ish Bllok ka hyrë dhe ka dalë shpesh, përpos të tjerave, edhe një ish deputete e PD-së, e cila më pas nisi të shfaqej me një makinë me vlerë 70 mijë euro.

Rrëfimet që përputhen me pamjet filmike tregojnë zonja dhe zonjusha të PD-së, të cilat shtriheshin në kolltuk para Gys Agasit siç u shtri Muç Nano në zyrën e Edi Ramës kur i kërkoi këtij të fundit t'a bënte ambasador në Zvicër pasi i ishte mërzhitur jeta në Tiranë. Gjithashtu, të paktën tetë deputetë të PD-së besohet se janë diktuar dhe kanë dalë nga zyra e Gys Agasit, ndërsa numri i kandidatëve në lista është më i lartë.

Ndërkaq, vizitat e drejtorëve, deputetëve dhe ish ministrave të PS-së në zyrën e Agasit ishin të zakonshme. Një ish drejtoreshë e rëndësishme, kur kishte telashe me SPAK-un, e kishte zyrën si ngushëllim, ku shfaqej, qante dhe dilte me një çehre më optimiste. Zyra e Gys Agasit është frekuentuar edhe nga analistë, gazetarë, diplomatë, biznesmenë etj. Siç edhe pretendon vetë Agasi, në shumicën e takimeve nuk ka asgjë të paligjshme.

Pjesa më e sikletshme e pamjeve filmike për SPAK-un është shfaqja e disa njerëzve të drejtësisë në zyrën e Gys Agasit. Sipas burimeve, zyra e Agasit është vizituar edhe nga nga dy prokurorë të SPAK-ut, ndërsa frekuentimi nga disa gjyqtarë dhe prokurorë ka qenë i zakonshëm. Madje, për të treguar se në këto takime nuk ka pasur asgjë të paligjshme, Agasi, gjatë marrjes në pyetje, ka kërkuar që të shfaqen edhe pamjet filmike të prokurorëve të SPAK-ut në zyrën e tij.

Fuqia e Gys Agasit nuk ishte aspak legjendë urbane. Ai kishte ndikim të fortë në disa degë kyçe të shtetit. Kjo fuqi tashmë besohet se ka kaluar në duart e një tjetër personazhi. Ai quhet Ron Yeffet, i konsideruar si 'Fazlliçi' i pushtetit aktual, i lakuar për seri mashtrimi me pasoja të tënda, në kërkim dhe non grata nga Afrika deri në Izrael (vendin e tij). Duke përdorur kredencialet e Ramës, Ron Yeffet hap çdo zyrë shteti, para tij raporton çdo ministër dhe drejtor, ndërsa takimet i zhvillon kryesisht në vilat qeveritare, i ruajtur nga Garda e Republikës.

Nuk është biznesmen. Nuk prodhon asgjë, përpos se trafikut të

Intiuençave dhe kthimit të lidhjeve dhe ndikimit në kontrata, aksione dhe para. Vetëm me Timak, ka arritur të marrë deri më tani 34 milionë euro, pa bërë asgjë dhe duke manipuluar bilancet për devijimin e parave në rrugën e xhepave pa kthim. Siç e tha edhe në përgjime, mediat do flasin dhe zhurmë do ketë, por fokusi do të jetë objektivi, ku tashmë në shenjestër janë sektorë si shëndetësia, arsimi, uji dhe sidomos nafta.

Dosja e AKSHI-t po zgjerohet dhe, bashkë me të, po shtohen edhe emrat e zyrtarëve të lartë që kanë pasur role në institucione kyçe. Në këtë histori shfaqen Vlora Hyseni, Mirlinda Karçanaj dhe Dallëndyshe Bici, tre gra që kanë drejtuar institucione të rëndësishme dhe që, në momente të ndryshme, janë përfshirë në zhvillime që lidhen me emrin e biznesmenit Ergys Agasi.

TAG:

Grate e PD

Mirlinda Karçanaj

Vlora hyseni

Zyra e gys agasit

Të ngjashme

Çifti Brunilda Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, AKU mjaftohet me një gjobë ndaj kompanisë INITALY ...

500 mesazhe / "Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te Gys Agasi për takimet me krerët e shërbimeve partnere dhe sur...

Pasuria e 'çmendur' e Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tendera në FSHZH, KESH dhe Bashkinë e Shkodrës

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.